



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“TOP KOSOVA” SH.P.K.
Nr. i biznesit 70576708
Pronare – Emine HOTI
OSHP TOP KOSOVA INFO
Rr/Luan Haradinaj, Pallati Rilindja
Prishtinë

“Tribuna Media Group” SH.P.K.
Nr. i biznesit 71110257
Pronare - Besiana HOTI
Rr/Mark isaku nr. 44
Prishtinë

Ref: 150/101/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë, skemës programore dhe emrit të Ofruesit të Shërbimeve Programore
TOP KOSOVA INFO - Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Top Kosova Info është Ofrues i Shërbimeve Programore, i cili është i licencuar për transmetimin e programit të tijë përmes sistemit kabllorë. Top Kosova Info është pajisur me licencë të KPM-së për Ofrues të Shërbimeve Programore, me datën 15 qershor 2009.
3. Më datën 22 janar 2015, pronarja e OSHP Top Kosova Info ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e pronësisë nga “TOP KOSOVA” SH.P.K., në emër të cilës është lëshuar licenca e KPM-së, tek “Tribuna Media Group” SH.P.K. me pronare znj. Besiana Hoti si dhe ndryshimin e emrit në Tribuna Channel.
4. Përfaqësuesja e “Tribuna Media Group” SH.P.K. znj. Besiana Hoti, ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e formatit të programit. Propozimi për formatin i ri të

1/3

programit duke theksuar se programi do të jetë ekskluzivisht i karakterit informativ dhe se rreth 95% e programit do të jetë prodhim vetanak.

5. Kandidatja për pronare të re ka theksuar se ndryshime do të ketë edhe në stafin menaxherial të Tribuna Media Group” SH.P.K. Si pjesë përbërëse e kërkesës së parashtruar, janë bashkangjitur edhe kopjet e diplomave universitare mbi kualifikimin e tyre, në pajtim me Rregullore KPM - 2013/04.
6. “TOP KOSOVA “SH.P.K. ka bashkangjitur faturat mbi pagesën e taksës vjetore për licencë të KPM-së, për vitin 2013 dhe 2014 duke shlyer të gjitha obligimet ndaj taksës për licencë.

Arsyetimi

7. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.*
8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.*
9. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
10. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
11. KPM konstaton se, kandidati ka treguar gatishmëri për të investuar në zhvillimin e programit, i cili do të jetë kryesisht i karakterit informativ dhe në interes të publikut, dhe gjithashtu e vlerëson si mjaft inkurajues deklarimin se rreth 95% e programit të kandidatit do të jetë i prodhimit vetanak.
12. KPM konstaton se, kandidati për pronar të ri ka dëshmuar që do të angazhojë staf të ri menaxherial i cili në aspektin profesional është i kualifikuar, ashtu siç kërkohet me rregullorën për dhënjen e licencës së KPM-së,(KPM-2013/04).
13. Në pajtim me nenin 15.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Zyra Ekzekutive konstaton se, kandidatit i propozuar për pronar të ri kualifikohet për t’iu transferuar licenca dhe se i njëjti i përmbushë kriteret dhe standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
14. KPM konstaton se, kërkesa për nsdryshimin e emrit në TRIBUNA CHANNEL mund të konsiderohet e arsyshme dhe pranueshme për KPM-në.

15. Përveç ndryshimeve në pronësi, në skemën programore dhe në emrin e të licencuarit, nuk do të ketë ndryshime që kanë të bëjnë me afatshmërinë e licencës.


Vendim

16. Në takimin e datës 24 shkurt 2015, Komisioni merr vendim për ndryshimin e pronësisë së OSHP Top Kosova Info duke e kaluar pronësinë nga "TOP KOSOVA" SH.P.K me numër të biznesit 70576708, në pronësi të "Tribuna Media Group" SH.P.K. me numër të biznesit 71110257, me pronare znj. Besiana Hoti dhe licenca e OSHP Top Kosova Info të ndryshohet sipas kërkesës së kandidatës.

17. Komisioni merr vendim për ndryshimin e skemës programore si dhe të emrit nga OSHP Top Kosova Info në PSHP Tribuna Channel, sipas kërkesës së parashtruar nga kandidati për pronar të ri.

Lëshimi i Vendimit

18. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



26.02.2015

datë